

Dalës-izlazna

Nr. X-1080 Data 30.12.2020  
Br. Datum

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Komuna e Obiliqit - Opština Obilic - Municipality Obiliq

### Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr.10/2018, e UA nr.07/2017, rregullimi i procedurave në sektorin publik, dhe kërkesën me nr. -X-1079, e datës 29.12.2020, Drejtoria e Arsimit më 30.12.2020, shpall :

### KONKURS

( Për plotësimin e vendeve të punës)

- **SHFMU"Dr. Ibrahim Rugova " në Obiliq**  
1.Vendi i punës : Një mësimdhënës të gjuhës gjermane, zëvendësim i pushimit të lehonisë
- **SHFMU"Hasan Prishtina " në Milloshevë**  
1.Vendi i punës : Një mësues klase  
2.Vendi i punës : Një mësues klase, zëvendësim i pushimit të lehonisë  
3.Vendi i punës :Një mësimdhënës e TIK-ut, zëvendësim i pushimit të lehonisë
- **SHFMU"Fazli Graçevci" në Hade dhe "Abdurrahmon Gërguri " në Darshishtë**  
1.Vendi i punës : Një edukatore, zëvendësim i pushimit të lehonisë
- **SHFMU"Pandeli Sotiri " në Obiliq**  
1.Vendi i punës : Një mësues klase, zëvendësim i pushimit të lehonisë

#### Kushtet për mësimdhënës :

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit Nr.04/L/032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ (MASHT), nr.10/2018, Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional Të Arsimit Të Përgjithshëm.

Kandidatët që konkurojnë për mësimdhënës duhet ta sjellin : diplomën e fakultetit të vërtetuar apo noterizuar(kopje), vërtetimin për përvojën e punës, certifikatën e lindjes, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën nën hetime.

Kandidatët, që konkurrojnë për këto vendet të punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuara në MASHT nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e Pritëse të KK-së, apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë. Kandidatët do të ftohen në intervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit.

Drejtori : Rexhep Zeka

